

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nr.regj.16631/12

AGJENSIONI KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCY AGAINST CORRUPTION	
DPK/OMP	No. Pril. 03-20/2013
02	Datim 08.01.2013

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, sipas gjyqtarit **Ramush Ademi** me sekretaren juridike Mejrime Tahiri, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehures Gjyzide Ismajli nga fsh.Malishevë k.Gjilanit ,për shkak të kundërvajtjes nga neni 17 parag.1.5 të Ligjit për deklarinimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin e,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar. Gaz. Zyr. 04/L-050 , në bazë të nenit 73 ,74,195,199 dhe 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 28.12.2012 muar këtë:

AKTVENDIM

E PANDEHURA Gjyzide Ismajli nga babai Ahmet, e lindur më 27.06.1958 në fsh.Zhiti K.Vitis, me vendbanim në fsh.Malishevë k.Gjilanit , shqiptare, Shtetase e R.Kosovës ,me profesion Gjuhëtare-fak.gjuhë dhe Letersi Shqipe, e martuar nënë e tre femive , me gjendje të mesme ekonomike, kinse nuk është I denuar e as nën hetime,

ËSHTË PËRGJEGJËSE

Sepse me dt. 13.09.2012, është bërë kërkesa për inicimin e procedurës kundërvajtëse, ndaj të paraqiturës më lartë e cila nuk e ka lajmëruar pasurin si zyrtare e lartë –këshilltare e Asambles Komonale të Kuvendit Komunal Gjilan, gjegjësisht në afat prej 15 ditësh nga dita kur është ftuar në agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë, për ta përmirsuar formularin mbi lajmërimin e pasurisë, e njejtja fare nuk është lajmëruar .

- me këtë veprim ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni 17 Parag.1,1.5 të Ligjit për deklarinimin,. Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë public dhe deklarinimin e,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar. Gaz. Zyr. 04/L-05 e për ate në bazë të dispozitave të cekura juridike , shpallet përgjegjëse dhe ,

DËNOHET

Me **DËNIM GJOBE** në shumë prej 200 (dyqindë) **EURO**, të cilën gjobë e pandehura është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me **DËNIM BURG** në kohëzgjatje prej 13 dite duke llogaritur 15 **EURO** për një ditë burgu të filluar.

Nga një kopje e aktvendimit u dërgohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Agjensioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë , me kërkesen e vet nr. Z.D/DPK.01-3910/12 të dates 31.10,2012, ka kërkuar që ndaj të pandehures të zhvillohet procedura kundërvajtëse të shpallet përgjegjëse dhe të dënohet sipas Ligjit.

Gjykata shqyrtoi kërkesen e parashtruar dhe konstatoi se e njejtja është e bazuar në Ligj.

Vepra kundërvajtëse dhe përgjegjësia e të pandehures në procedurë te kjo gjykatë është vertetuar në bazë të shkresave të parashtruar dhe marrjes në pyetje të pandehuren e cila në mbrojtjen e vet ka deklaruar: se vërtetë në afatin ligjor e ka dorëzuar të plotësuar formularin për deklarinimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarve të Lartë Publik, , por pas sa ditesh pas dorëzimit të formularit në agjensionin e lartëpërmendur nga zyrtari I agjensionit ëshë ftuar me telefon që në afat prej 15 ditesh ngadia e informimit përmes të telefonit te shkoj në lokalet e agjensionit kundër korrupsionit në Prishtinë për një këshillim dhe përmirsim të formularit të dorëzuar , por e pandehura nuk është lajmëruar në selin e agjensionit , andaj I është bërë kërkesa dhe fletëparaqitja për kundërvajtjen e kryer sipas nenit 3 lidhur me nenin 17 parag. 1 , 1.5 të Ligjit për deklarinimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik.

E pandehura në mbrojtjen e vetë ka pohuar se vertet nuk ka shkuar për tu lajmëruar tek bërsi I kërkeses në afatin e parapar pas informimit andaj konsideron se ka gabuar dhe e pohon kundërvajtjen që I vihet në barrë .

E pandehura në mbrojtjen e vetë ka cekur edhe këtë se ka tre fëmijë të cilet janë student prandaj lut gjykatën që mudësisht ti shqiptohet ndonjë dënim sa më I butë. Për shkak të gjendjes jo të volitshme financiare.

Gjykata për vertimin e të drejtës materiale, me kujdes ka vlersuar mbrojtjen e të pandehures kërkesen dhe shkresat e tjera të lëndës dhe arriti bindje të plotë, se e pandehura ka kryer kundërvajtjen që I vihet në barrë, andaj e shpalli përgjegjëse, dhe I shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 euro , duke e zbutur dënimin nën minimumin e parpar duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Me rastin e shqiptimit të këtij lloji të dënimit Gjykatësi pati parasysh si rrethana letësuese se e pandehura është në pozitën e Zyrtares së lartë si këshilltare e Asambles Komunale KK.Gjilan por të ardhurat janë shumë të vogla se kjo është kundërvajtja e parë, është zotuar se në të ardhmen nuk ka për të përsëritur kundërvajtje të tillë, tre fëmijë student ,andaj I shqiptoi këtë dënim ndërsa si rrethanë renduese e mori peshën e kundërvajtjes së kryer , e bindur se edhe me këtë dënim ka për tu arritë qëllimi I dënimit tek e pandehura. Që në të ardhmen që të mos përsëris kundërvajtje të këtillë, apo të ngjashme.

Me të lartëpërmenduren u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN,
Më dt.28.12.2012

Sek.juridike
Mejreme Tahiri




Gjyqtari,
Ramush Ademi



UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.